

SHKALLËT E BESIMTARËVE NË RRUGËTIMIN DREJT ALLAHUT (MEDAARIXH ES-SAALIKIIN)

Lumturia / *es-Suruur* / السُّرُورُ

Dr. Hatim el-Haxh

Materiali është përmbledhje e kuptimeve të audio-ligjëratës nga nxënësit e hoxhës

<https://buff.ly/2hbVv4T>

Allahu ﷻ tha:

"قُلْ بِفَضْلِ اللَّهِ وَبِرَحْمَتِهِ فَبِذَلِكَ فَلْيَفْرَحُوا"

“Thuaj: ‘Të mirave të Allahut dhe mëshirës së Tij le t’i gëzohen.’” (Junus, 58)

Es-Suruur (lumturia) është një emër që shënon ngazëllimin e çiltër (*istibshaar*)¹. Kjo është me e pastër sesa gëzimi (*farah*), meqë gëzimi mund të jetë i përzier me pikëllim dhe kjo është arsyeja përse Kurani përmend *farah* në raste të ndryshme lidhur me gëzimin e kësaj bote. Lumturia (*suruur*) përmendet në dy raste në Kuran për t’iu referuar gjendjes së lumturisë në ahiret.² Në këtë kontekst, kjo ka tri nivele:

Niveli i parë është lumturia e shijimit (të besimit) e cila largon tri lloje të pikëllimit:

- Pikëllimit që shkaktohet nga frika e braktisjes³
- Pikëllimit që është i përzier me errësirën e injorancës
- Pikëllimit që është i mbuluar nga vetmia e shkapërderdhjes⁴

¹ *Istibshaar* vjen nga rrënja e njëjtë si *bushraa* (sihariq), prandaj dhe kjo lumturi është e përzier me optimizëm, pozitivitet dhe vetëbesim për të ardhmen. Kjo është një lumturi pa brenga. Burimi i vetëbesimit është besimi në mëshirën e Allahut, jo mbështetja në punët që bëjmë.

² Edhe *farah* (gëzimi), edhe *suruur* (lumturia) përmenden në Kuran si në kontekstin negativ, ashtu dhe në atë pozitiv.

³ Të liresh mbrapa karvanit dhe të shkëputesh nga Zoti.

⁴ Plotnia arrihet vetëm në bashkësi me të Vërtetin dhe të Shenjtin. Çfarëdo ndarje prej Tij dhe çfarëdo shpërqendrimi që ta bën çdo gjë tjetër (*es-Siwa*) shkakton fragmentim të shpirtit dhe shkapërderdhje.

Niveli i dytë është lumturia që vjen nga të parët⁵ e cila:

- Heq perden e dijes⁶
- Thyen prangat e barrëve (të detyrave fetare)⁷
- I jep fund ultësisë së konsideratës ndaj zgjedhjeve⁸

Niveli i tretë është lumturia e të dëgjimit nga pranuesi e cila:

- Heq ndikimin e vetmisë
- Troket në portën e të parit⁹
- Shtyn shpirtin të qeshë¹⁰

⁵ Të parët e akteve hyjnore dhe të hirit hyjnor.

⁶ Dija për aspektet teknike që nuk shoqërohet nga një gjendje e mirë (*haal*), mund të përbëjë pengesë.

⁷ Detyrat fetare nuk janë barrë më, por një burim i lumturisë dhe i energjisë.

⁸ Në këtë shkallë, personi heq dorë nga zgjedhjet që i ka në dispozicion. Allahu thotë:

“Nuk i përket një besimtari e as një besimtareje që, kur Allahu dhe i Dërguari i Tij të kenë vendosur për një çështje, të bëjë zgjedhje tjetër.” (el-Ahzaab, 36)

⁹ Ndryshe nga niveli paraprak, të parët këtu ka të bëjë me të parët e shfaqjeve hyjnore (*texhel’li*) nëpërmjet manifestimit të emrave dhe cilësive të Tij ndërsa je bashkë me Të.

¹⁰ Të qeshurit e shpirtit është një tregues i lumturisë përfundimtare të tij. Allahu thotë:

“Në atë Ditë, do të ketë fytyra të ndritshme, që i qeshen sihariqit (për pranimin në xhenet).” (Abese, 38-39)